

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“TEO” Sh.p.k.

Ne Tirane, sot me daten 25.01.2024 (dymije e njezet e kater) shtetasi:

1 Z. Qamil Male

Mblidhet, diskuton, bien dakort dhe vendos sa vijon:

NENI 1

Formohet shoqeria tregetare **TEO Sh.p.k.**

Nga Ortake themelues:

Z. Qamil Male, lindur me 15.12.1951, ne Leskovik, shtetas Shqipetar,Banues ne Rrugen selim Brahma Ndertesa nr 73 Sauk Tirane me ID Nr F11215093P te Kartes se identitetit.

Emertimi i shoqerise do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete ne adresen:

Ndertese 1 Kateshe Ish Vitrinat ,Zona Kadestrale nr 2105 dhe nr pasurie 1249/6 rruga Egnatia Tirane.

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne te gjithe juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim te ortakeve, mund te krijohen ose anullohen seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukturore te shoqerise si dege apo perfaqesi edhe jashte shtetit krijohen kur nje gje te tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.

NENI 4

Kapitali i shoqerise

Kapitali i nënhukuar i shoqërisë, është **100.000** (Njeqind mijë) lekë i ndare ne 1 kuote Kuotat e kapitalit te Shoqërisë zotërohen nga ortakët si më poshtë:

- Zoti **Qamil Male** zoteron 100% kuota ose **100.000** (Njeqind mijë) leke te kapitalit 1 kuote

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve. Ortaket mund te shesin kuotat e tyre personave te trete ne perputhje me dispozitat e legjislacionit te aplikuar dhe parshikimeve te statutit te kesaj Shoqerie.

Transferimi i Kuotave në rrugë trashëgimie bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe per gjithesht siç parashihet ne ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve. Në rastet e bashkëpronësisë veprohet ne zabatim te legjislacionit ne fuqi.

Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise dhe me investime personale te ortakeve konform miratimit paraprak te asamblese se ortakeve..

Ortaket kane te drejta pronesie mbi çdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge te ligjshme. Shoqeria per gjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 5

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte me nje afat te pacaktuar.

NENI 6

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi , ne perputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 7

Shoqeria çel llogari bankare ne monedhe shqiptare si edhe çdo lloj valute, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shteterore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financier të aktivitetit të saj.

Ortaket e Shoqerise ose Administratori i emeruar prej tyre, depozitojne faksimilet e firmave të tyre orgjinale ne Bankat ku eshte çelur llogaria bankare.

NENI 8

Ortaket, kane të drejte të transferojne jashte territorit të Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre perfshire dhe fondet dhe kontributet e pjeseve të kapitalit themelor, Transferimet duhet të jene të vertetuara me Akt Notieral dhe per nje gje të tille duhet të marre paraprakisht vendim me shkrim Asambleja e Ortakeve.

Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime apo tu behen të ditura.

NENI 9

Shoqeria krijohet per të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit qe do te jete :

Import-Eksport mallrash industriale. Prodhim,tregetim i produkteve plastike dhe metalike.

NENI 10

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, shoqeria mund të zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtimet të tjera të cilat jane me interes per mbarvajtjen e shoqerise.

NENI 11

Me vendim të Asamblese se ortakeve, shoqeria mund të zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake të tjere, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me nje shoqeri tjeter tregtar si brenda vendit dhe jashte saj.

NENI 12

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte Organi me i Larte Drejtues dhe Vendimor i shoqerise dhe ai ushtron të gjitha kompetencat qe ligji " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare " i njeh asamblese se ortakeve qe jane krijuar me ortakeri.

Ortaket mund t'ia delegojne kompetencat nje ose me shume administratoreve të caktuar prej tyre ose dhe nje personi fizik jashtë ortakerise se shoqerise, vetem mbi bazen e prokures.

NENI 13

Administrator i shoqerise **TEO Sh.p.k.** eshte:

Duke filluar nga data e miratimit të këtij statuti, administratoret e shoqërisë "**TEO**" shpk për një periudhë 5-vjeçare do të jenë

Z..Qamil Male madhor, lindur me 15.12.1951, ne Leskovik, shtetas Shqipetar,Banues ne Rrugën selim Brahma Ndertesa nr 73 Sauk Tirane me ID Nr F11215093P te Kartes se identitetit .

Adminsitratori i shoqerise gezon te gjitha te drejtat qe ligji « Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare » parashesh, pa asnje kufizim te kompetencave.


Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

NENI 14

Ky akt themelimi u redaktua ne 5 ekzemplare, ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera të njejta juridike dhe eshte i vlefshem kur vertetimi i autenticitetit të nenshkrimit eshte bere nga Noteri.

ASAMBLEA E ORTAKËVE

QAMIL MALE



Tirane me , 25/01/2025